




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Referencë:	
Për/Za/To:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
CC:	
Përmes/Preko/Throgh:	
Tema/Subjekat/ Subjekct:	Raporti për Takimin Publik lidhur me gjashtë mujorin e parë të punës së Ekzekutivit për vitin 2026

Raporti është përgatitur duke u bazuar në UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË.

Më datë 29.06.2026 është mbajtur Takimi Publik i Kryetarit të Komunës së Kamenicës për prezantimin e punës dhe aktiviteteve të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Takimi është mbajtur duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal. Takimi është organizuar nga Kabineti i Kryetarit dhe Zyra për Informim.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në Facebook:

Më datë 09.06.2026 është publikuar njoftimi për organizimin e këtij Takimi Publik që do të mbahej. Njoftimi është publikuar në Web-faqen e Komunës dhe në Facebook-un e Komunës.

-Publikimet në uebfaqe:

Shqip/Serbisht: <https://kamenice.rks-gov.net/njoftim-per-takimin-publik-te-kryetarit-te-komunes-per-gjashte-mujorin-e-pare-te-vitit-2026/>

-Publikimet në Facebook:

Shqip/Serbisht:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid02gGpgZaCra33D7KiRdKXexX8QuP7ciyhQEFrufeJrhGKjNiUbdceUFMrBniBDFvS2l>

Ndërsa më datën 29.06.2026 duke filluar nga ora 10:00 është mbajtur Takimi Publik, ku është paraqitur para të pranishmëve Raporti për gjashtëmujorin e parë të punës së Ekzekutivit, dhe të pranishëm kanë qenë 39 qytetarë.

Të pranishëm kanë qenë Kryetari Kadri Rahimaj, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë

komunalë, media dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile

Hapja e takimit është bërë nga Kryetari Rahimaj, i cila ka falënderuar të pranishmit dhe më pas ka prezantuar punën gjashtëmujore sipas sektorëve: arsimi, infrastruktura, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, rendi dhe rregulli, mirëqenia dhe përfaqësimi.

Në arsim u prezantuan investimet dhe aktivitetet, përfshirë shpërblimin e maturantëve më të mirë, diplomimin e maturantëve, pasurimin e bibliotekave me 6,750 libra, inaugurimin e këndit të leximit dhe kabinetit të logopedisë, organizimin e Kupës së Anamoravës në matematikë dhe përgatitjet për mësimin tërëditor.

Në infrastrukturë u prezantuan projektet rrugore me investime shumëmilionëshe, rehabilitimi i rrugëve rajonale e lokale, ndërtimi i rrugëve kufitare, shtrati i lumit Astrit, asfaltimet në fshatra dhe qytet, si dhe projektet që pritet të nisin së shpejti.

Në shëndetësi u prezantua dhe sigurimi i autoambulancës së re.

Në zhvillim u prezantuan rezultatet e NPL 'Dardana', grantet për bizneset, subvencionet për kulturë, rini e sport, Parku i Aventurave, masterplani për Bahçen e Kamenicës, kompostimi, rindërtimi i kadastrit, View Point-et dhe çmimi për digjitalizim.

Në rend dhe rregull u prezantuan aksionet kundër strukturave paralele, puna e inspektoratit dhe lirimi i hapësirave publike. Në mirëqenie u prezantuan investimet në ujësjellës, Baby Box dhe lodrat për parqe. Në përfaqësim u prezantua pjesëmarrja e Komunës në CEBC 2026 në Austri. Në fund Kryetari Rahimaj ka treguar edhe buxhetin për vitin 2025.

Pas përfundimit të prezantimit, Kryetari i Komunës, Kadri Rahimaj, hapi debatin për pyetje, komente dhe sugjerime nga të pranishmit.

Qytetari Ismet Qehaja përgëzoi Komunën për punët e realizuara dhe ngriti disa shqetësime lidhur me hapësirën prapa lokalit “Chaplini”, konkretisht për garazhet e papërdorura, gjendjen e murit mbajtës dhe mungesën e rregullimit të parkingjeve. Ai theksoi se, ndonëse në mënyrë vullnetare kishte pastruar hapësirën dhe kishte vendosur ndriçim, qasja mbetet e vështirësuar për shkak të zënies së rrugës. Po ashtu kërkoi që Komuna të ndërhyjë në organizimin e parkingjeve dhe ngriti shqetësimin për përdorimin e agregatëve nga bizneset, të cilët, sipas tij, shkaktojnë zhurmë dhe ndotje të ajrit. Gjithashtu ai u ndal edhe te çështja e garazheve, duke theksuar se, megjithëse ekziston vendim për largimin e tyre, mungon një model i qartë se si duhet të ndërtohen garazhet e reja për të mbrojtur automjetet nga kushtet atmosferike.

Kryetari Kadri Rahimaj u përgjigj se çështja e parkingjeve është një nga sfidat kryesore në qytet dhe njoftoi se është iniciuar themelimi i një komisioni për hartimin e Rregullores për Parkingje. Pas miratimit nga Kuvendi Komunal, menaxhimi i parkingjeve do t'i besohet Ndërmarrjes Publike, duke përfshirë edhe parkingjet rezidente për banorët. Sa i përket problematikave në banimin kolektiv, si agregatët, hyrje-daljet dhe hapësirat e përbashkëta, ai theksoi se është formuar një komision për trajtimin e tyre, ndërsa banorët duhet të zgjedhin përfaqësuesit e hyrjeve në mënyrë që Komuna të ketë bazë ligjore për ndërhyrje dhe investime.

Qytetari Nazmi Ajeti ngriti shqetësime lidhur me shfrytëzimin e hapësirave publike nga bizneset, vendosjen e agregatëve dhe ventilatorëve që shkaktojnë ndotje dhe erëra të pakëndshme, zënien e parkingjeve publike dhe shqetësimet nga zhurma gjatë orëve të vona të natës. Ai kërkoi angazhim më të madh të Inspektoratit Komunal për trajtimin e këtyre rasteve.

Kryetari Rahimaj bëri të ditur se Drejtoria kompetente dhe Inspektorati do të merren me trajtimin e këtyre shqetësimeve, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve që respektojnë interesin e të gjitha palëve.

Qytetarja Sabile Kastrati ngriti shqetësime lidhur me sigurinë në Shkollën e Karaçevës së Epërme, duke theksuar rrezikun nga rrëshqitja e dheut prapa objektit të shkollës, mungesën e shkallëve në hyrjen kryesore dhe mungesën e mbrojtëseve pranë përroit, çështje që sipas saj paraqesin rrezik për nxënësit.

Kryetari Rahimaj tha se çështja e rrëshqitjes së dheut do t'i përcillet ndërmarrjes kompetente për ndërhyrje në terren.

Zyrtarja Vlonë Matoshi sqaroi se shkallët janë larguar gjatë realizimit të projektit për të orientuar nxënësit drejt hyrjes së planifikuar, ndërsa bëri të ditur se do të ndërtohet dhe asfaltohet rruga anësore deri te hyrja e shkollës.

Qytetari Ardian Dermaku kërkoi rregullimin e një rruge prapa marketit Viva Fresh në Kamenicë, duke theksuar gjendjen e rënduar të saj.

Kryetari Rahimaj u përgjigj se Drejtoria për Investime do të dalë në terren për ta vlerësuar gjendjen dhe mundësinë e intervenimit.

Qytetari Rexhep Bugaçku ngriti shqetësimin për një projekt të papërfunduar të kanalizimit në lagjen ku banon, si dhe problemin e ujërave atmosferike që depërtojnë në oborrin e tij. Ai gjithashtu përmendi çështjen e punësimit, duke theksuar se djali i tij është i kualifikuar, por nuk ka kërkuar asnjëherë favore.

Kryetari Rahimaj sqaroi se të gjitha punësimet realizohen në përputhje me procedurat ligjore, ku testet dhe komisionet përcaktohen nga niveli qendror dhe Komuna nuk ka mundësi ndërhyrjeje. Ai inkurajoi të gjithë qytetarët, përfshirë edhe djalin e z. Bugaçku, që të aplikojnë në konkurset publike, duke theksuar se proceset e rekrutimit zhvillohen me transparencë të plotë.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet/Pyetje	Njoftimi
Diskutim publik për gjashtëmujorin e parë të 2026-ës për punën e Ekzekutivit	Zyra e Kryetarit	39 pjesëmarrës	Salla e Kuvendit Komunal	5	-Publikimet në uebfaqe: Shqip/Serbisht: https://kamenice.rks-gov.net/njoftim-per-takimin-publik-te-kryetarit-te-komunes-per-gjashtemujorin-e-pare-te-vitit-2026/ -Publikimet në Facebook: Shqip/Serbisht: https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid02gGpgZaCra33D7KiRdKXeXx8QuP7ciyhQEFrufeJrhGKjNiUbdceUFMrBniBDFvS2l

Zyrtare për Diskutime Publike:
Valdete Berisha-Murina



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes në takimin publik të Kryetarit për gjashtë mujorin e parë të 2026

Data: 29.06.2026

Ora: 10:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Gjinia	Vendbanimi	Nënshkrimi
Br.	Ime i prezime	Pol	Prebivalište	Potpis
1.	Nozim Ajiti	M.	Dardone	
2.	ISMET QENJA	M.	DARDAN	
3.	SELAMI ZHIFU	M	KOPERNICË	
4.	Rafet Bonova	M	Kamenica	
5.	Blerim Shillova	M	~11~	
6.	Ardan Dëmdar	M	Shp. e pame	
7.	ZIJADIN HAKI	M	DARDAN	
8.	Violeta Krasniqi	F	Kamenicë	
9.	Sahib Arifi	F	Kamenicë	
10.	ARONA DERMARU	F	KAMENICE	
11.	Bashkimo Leka	F	Benirojicë	
12.	Selami Klauqi	M	Topanica	
13.	KASER HOTI	M	KAMENICË	
14.	BESA MORINA	F	Gjilan	
15.	Ujollca Azem	F	Kamenicë	
16.	Almira Spahiu Begiraj	F	Kamenicë	
17.	Anber Hoxha	M	KOPERNICË	
18.	EMIR DËRMAKU	M	SHIPASHVIC	

19.	Shyssa Jerkai	M	Kacenicë	<i>[Signature]</i>
20.	Bujar Kastrati	M.	Hogosht	<i>[Signature]</i>
21.	Abdullah Kumbur	M	Korçun	<i>[Signature]</i>
22.	FEHMI JAKUPI	M	RUBO e	<i>[Signature]</i>
23.	Blerim Murina	M	Topanice	<i>[Signature]</i>
24.	Mirza Kryeziu	F	Pogane	<i>[Signature]</i>
25.	Visar Dermaku	M	Shipshime	<i>[Signature]</i>
26.	Sabit Zyfi	M	Kopernice	<i>[Signature]</i>
27.	Valmir Remadani	M	PETRI	<i>[Signature]</i>
28.	Shaqir Lekçi	M	Petrit	<i>[Signature]</i>
29.	Bujar Fetiu	M	Koretin	<i>[Signature]</i>
30.	VLONË MATOSHI	F	KAMENICE	<i>[Signature]</i>
31.	ZORRIM KASTRATI	M	KARAGJUR	<i>[Signature]</i>
32.	Recep Rugova	M	Korçun	<i>[Signature]</i>
33.	Shpend Morina	M	HODONOC	<i>[Signature]</i>
34.	Rifat Hajoluni	M	Kacenicë	<i>[Signature]</i>
35.	Erion Morina	M	Topanice	<i>[Signature]</i>
36.	AMIRE ISMAJLI	F	KAMENICE	<i>[Signature]</i>
37.	Vedat Berisha	F	Topanice	<i>[Signature]</i>
38.	Rona Myrtaj	F	Kopernice	<i>[Signature]</i>
39.				
40.				
41.				
42.				
43.				
44.				
45.				
46.				
47.				